



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.271/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje-LVV, paraqitur kundër Avni Ibrahimimi për shkak të fotografimit të votës gjatë procesit të votimit, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 15.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr. 271/2017 e datës 12.06.2017 parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje-LVV.

A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje-LVV, në të cilën thekson se gjatë procesit të votimit në vend vototimin shkolla fillore “Dardania” 1904e/06 ka konstatuar se Avni Ibrahimimi ka fotografuar votën e tij, në pranani të dëshmitarëve të këshillit të vendvotimit.

Sipas parashtruesit të ankesës personi në fjalë nën dyshimin e arsyeshëm ka kryer veprën penale nga neni 218 të Kodit Penaltë Republikës së Kosovës me nr.04/L-082 *Cenimi i fshehtësisë së votës* si dhe sipas rreftës zgjedhore nr. 09/2013 neni 15 par 4.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenin 117 par. 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

PZAP-i konstaton se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi në cilësi të provës edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e

ankesës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 i LZP-së për të provuar se shkelësi i supozuar e ka fotografuar votën e tij gjatë ditës së votimit në qendrën e votimit të lartcekur.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 271/2017 më datën 15.06.2017

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.